



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 8/5 Prot

Tiranë më, 16/01/2020

**Lënda:** Kërkesë për shpjegime lidhur sqarimet e bëra Bordit të Administrimit për detajimin e fondit të dhënë nga MASR për vitin 2020

**Drejtuar:** Z. Arben Ilollari  
Zyra e Financës ASA

**KËTU**

I nderuar Z. Ilollari,

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 8/3 prot., datë 15.01.2020, lidhur me sqarimet e dhëna Bordit të Administrimit për detajimin e fondit të dhënë nga MASR për vitin 2020, është e nevojshme saktësimi i informacionit sa më poshtë:

1. Buxheti i miratuar për vitin 2019 me vendimin nr. 1, datë 14.01.2019, të Bordit të Administrimit ka qenë për 123 punonjës jo për 118 punonjës. Kur është i njëjti numër punonjësish edhe këtë vit, (pra 123 punonjës si për vitin 2019, po kaq edhe për vitin 2020), lutem shpjegoni në mënyrë të detajuar rritjen e pagave?

Në shkresën tuaj nr. 8/3 prot., datë 15.01.2020, sqaroni që rritja e fondit të pagave është e lidhur me ndryshimet e brendshme të personelit si numri dhe ndryshimi i pozicionit të punonjësve sipas titujve dhe gradave. Për këtë ndryshim duhet një analizë konkrete specifike në kuadër të miratimit të shifrës së vitit të kaluar në buxhet. Kjo analizë duhet të tregojë sa është ndryshuar **numri i stafit** nga numri 123 i miratuar në buxhetin e vitit 2019, **cilat pozicione** kanë ndryshuar konkretisht që kanë ndikuar në rritjen e Art 600 dhe **cfarë tituj** kanë ndryshuar që kanë ndikuar në rritjen e Art 600. Ky informacion të pasqyrohet në formën e një tablele.

**Pjesë e analizës për buxhetin e vitit 2019**

*Art 600, Për paga personeli, punonjës sezonalë*

*Viti 2019, numri i personelit është 123.*

*Për punonjësit sezonalë për projektet e Institutit të Arkeologjisë duhen 420 punonjës x 30,000 lekë = 12,600,000 lekë.*

*Pra në total*

*- Personeli 133,914,000 lekë.*

*- Punt.sezonale 12,600,000 lekë*

**Gjithsej shuma : 146,514,000 lekë.**

2. Gjithashtu kërkohet një shpjegim lidhur me diferencën e pagesës së miratuar nga bordi për 123 punonjës me pagë 133.914.000 lekë dhe 118 punonjës që në realitet kanë qenë faktikë në ASA. Cfarë është bërë me fondin e papërdorur? Lutem të sqarohet se për çfarë është përdorur diferenca e pagesës. Theksoj që ky përdorim i kësaj vlere monetare është bërë pa miratimin e bordit të administrimit dhe përbën shkelje ligjore.
3. Në shkresën nr. 8/3 prot. datë 15.01.2020 sqarohet që të ardhurat e arkëtuara për vitin 2019 janë caktuar për t' u shpenzuar në zërin shpenzime (Art 602). Lidhur me këtë çështje theksojmë që Bordi i Administrimit ka marrë dijeni për herë të parë për të ardhurat e arkëtuara nga ASA në shumën 9.291.655 lekë dhe caktimi i këtyre të ardhurave për t' u shpenzuar në zërin shpenzime (Art 602) është bërë pa miratimin e bordit të administrimit dhe përbën shkelje ligjore. Lutem të sqarohet nëse këto të ardhura janë deklaruar pranë MASR.
4. Lidhur me miratimin e 420 punëtorëve sezonalë të angazhuar në projekte të Institutit të Arkeologjisë, informacioni i paraqitur është i paplotë lidhur me nevojën për këtë numër punëtorësh.

Duke qenë se këta punëtorë nuk janë staf akademik, miratimi i tyre bëhet nga Bordi i Administrimit. Në shkresën 8/4 prot., datë 15.01.2020 është theksuar që shpërndarja e fuqisë punëtoare bëhet me miratim të Këshillit shkencor të institutit. Për sa më sipër është e nevojshme paraqitja para Bordit e këtij miratimi që ka bërë këshilli shkencor i Institutit të Arkeologjisë për vitin 2019. Gjithashtu është kërkuar të paraqitet një analizë se cili është personi përgjegjës për kontratat e tyre të punës si dhe për mbikqyrjen e tyre në punë. Përveç kësaj duhet të tregohet realizimi faktik i punës për vitin 2019 nga 420 punëtorët dhe listë pagesat për 420 punonjësit e parashikuar në buxhetin e vitit 2019. Pra sa punëtorë kanë qenë vitin 2019 faktikisht të përfshirë në projektet e Institutit të Arkeologjisë?

Sipas listëpagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurta nga punësimi së Muajit Tetor 2019 rezulton që kanë qenë 281 punonjës të ASA nga të cilët 118 janë punonjës të brendshëm të ASA dhe 163 janë punonjës të jashtëm (punëtorë sezonalë). Nga informacioni i marrë deri tani pranë Bordit nuk rezulton të jenë përdorur 420 punonjës sezonalë për vitin 2019.

Lidhur me kërkesën e bërë për 420 punëtorët sezonalë për vitin 2020 nga Instituti i Arkeologjisë, duhet që kërkesa të paraqitet e specifikuar lidhur me:

- 1) projektet konkrete që do të angazhohen punëtorët sezonalë;
- 2) numri i punëtorëve sezonalë për çdo projekt;
- 3) periudha e angazhimit të tyre dhe grafiku i punës (në c' muaj kërkohen këta punonjës të janë të angazhuar)
- 4) kostoja e tyre për çdo projekt;
- 5) personat e angazhuar për mbikëqyrjen e punëtorëve, të shoqëruar me raporte të bëra për vitin 2019 lidhur me matjen e punës së punëtorëve sezonalë;
- 6) nevojën për t' i mbuluar nga buxheti i shtetit pagesat e punëtorëve sezonalë.

Këto kërkesa duhet të vijnë pranë Bordit të Administrimit për miratim dhe më pas të kërkohen fondet për këto veprimtari.

Për sa më sipër kërkesat e Bordit të Administrimit mbështeten në nenin 49 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" sa më poshtë:

- a) **garanton qëndrueshmërinë financiare** të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij;
- c) me propozim të Senatit Akademik, **miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm** të institucionit dhe **mbikëqyr zbatimin** e tyre;
- ç) me propozim të Senatit Akademik, **miraton numrin e personelit** në të gjitha nivelet;
- ë) **përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave** që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe **mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit**;

5. Theksojmë se me kaq informacion sa jepet nuk arrihet të kuptohet lëvizja monetare brenda ASA. Duke qenë se Bordi i Administrimit ka si funksion mbikëqyrjen e zbatimit të buxhetit, është e nevojshme të jepet informacion i detajuar mbi realizimin e buxhetit 2019 të ASA, duke u paraqitur pranë Bordit të Administrimit realizimi i buxhetit të miratuar për vitin 2019 të vulosur nga Dega e Thesarit Tiranë.
6. Lutem të jepet informacion nëse ASA ka fonde të papërdorura nga viti 2019 dhe nëse këto janë deklaruar në MASR dhe në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për t' u përdorur për vitin 2020.
7. Lutem të jepet informacion lidhur me miratimin e PBA 2020-2022 (plani buxhetor afatmesëm), i cili nuk ka kaluar pranë Bordit të Administrimit për shqyrtim dhe miratim.
8. Lidhur me transparencën e veprimtarisë së institucionit, lutem të jepet informacion nëse është miratuar dhe më pas publikuar në faqen zyrtare të ASA raporti i monitorimit sipas kërkesave ligjore në fuqi.

Duke qenë se informacioni i kërkuar sa më sipër kërkon kohë të përgatitet nga ana e ASA, propozohet të vijohet me miratimin e pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe

shërbimeve (drita, ujë dhe internet) për një periudhën 3 mujore, deri në plotësimin dhe saktësimin e çështjeve të ngritura nga bordi i administrimit. Referenca për përlogaritjen e shërbimeve do të merret nga buxheti i vitit 2019.

Miratimin e pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe shërbimeve (drita, ujë dhe internet) për një periudhën 3 mujore të bëhet pasi të saktësohet informacioni në pikën 1 të shkresës.

Faleminderit për mirëkuptimin,

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**



**Heliona MIÇO**